


TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Pluhur
Paketimi: Thes letre 25 kg në paleta 1350 kg
Ngjyra: E Bardhe
Konsumi: 3 m ² /thes/10 mm trashësi
Magazinimi: Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri
Koha e magazinimit: 12 muaj nga data e prodhimit
Trashësia minimale e aplikimit për mure: 10 mm
Reaksioni ndaj zjarrit: Klasa A1
Koha e punueshmërisë: 1-2 orë
Trashësia minimale e aplikimit për tavane: 8 mm
Densiteti i llaçit të thatë: 0.95 gr/cm ³
Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C
Aplikimi i materialit: Me dorë ose makineri, 1 dorë
Forca në shtypje pas 28 ditësh: ≥ 2.5N/mm ²
Konduktiviteti termik: 0.34 W/mK



dekoll®
PREMIX PER L'EDILIZIA



Dëshironi të dini më shumë mbi produktet tona?
Autostrada Tiranë - Durrës, Km 5.
www.dekoll.al | [+355 69 606 6656](tel:+355696066656) | info@dekoll.al



dekoll®
PREMIX PER L'EDILIZIA

PREGIPS PG-75



PËRSHKRIMI

Suva me bazë gipsi për aplikim me dore dhe makineri. PREGIPS është një llaç i parapërgatitur, me peshe të lehtë, me përmbajtje agregatësh cilesore dhe aditive specifike.

FUSHA E APLIKIMIT

PREGIPS përshtatet në mënyrë ideale mbi sipërfaqe betoni poroz, mure të ndërtuara me materiale të ndryshme me tulla porozo ose normale. Për krijimin e sipërfaqeve të lëmuara, lehtësisht të strukturueshme në mure dhe tavane për ambiente të brendshme. Suva një-shtresore për të gjitha sipërfaqet, beton si dhe sipërfaqe mbajtëse të suvuara më parë. Përdoret në të gjitha ambientet, nga çatia deri në bodrum me lagështi të zakonshme ajri, përfshirë kuzhinat dhe tualetet. Mund të përdoret si sipërfaqe për tu përpunuar më tej me bojë ose letra murale, për tu veshur me pllaka, ose për të aplikuar suva dekorative.

PËRGATITJA E BAZAMENTIT

Bazamenti duhet të jetë i pastër pa pluhura, vajra apo mbetje të cilat bëhen pengesë në lidhjen midis shtresave. Pastrimi i bazamentit bëhet në mënyrë mekanike. Fugat e tullave duhet të mbyllën paraprakisht për të pasur një mbulim pa plasaritje. Në bazamentet me beton të lemuar rekomandohet trajtimi i sipërfaqes me beton primer ndërsa në bazamentet me sipërfaqe shumë thithëse ose me pluhura rekomandohet trajtimi i sipërfaqes me astar akrilik.

PËRGATITJA E SUPORTIT

Produkti është i përshtatshëm për tu punuar me dorë dhe makineri. Përgatitja realizohet përmes një përzierje intensive në makinerinë e suvasë. Sasia e ujit që duhet është e rregulluar në mënyrë të tillë që të arrihet një konsistencë e hollë, e cila lejon të punohet në trashësinë e kërkuar pa problem mbi sipërfaqen në dispozicion. Brumi kremoz i gipsit lejon të shtyhet lehtë nga koka e pistoletës së pompës dhe krijon një shtresë suvaje të njëtrajtshme, të lehtë për tu shpërndarë.

APLIKIMI

Suvatë për makineri vendosen si rregull në trashësi shtrese nga 10 deri 35 mm. Suvaja me bazë gipsi spërkatet në masë të njëtrajtshme nëpërmjet kokës së pistoletës me presion në trashësinë e dëshiruar. Nëpërmjet presionit të spërkatjes realizohet një ngjytje më e mirë e suvasë mbi sipërfaqe, meqenëse gipsi futet thellë në fugat e sipërfaqes që do të suvatohet. Pasi materiali sprucohet, llaçi shpërndahet horizontalisht dhe vertikalisht. Me fillimin e fortësimit të shtresës, sipërfaqja tërhiqet me mastar ose mallë në mënyrë që të eliminohen disnivelet. Në rast se shtresa përfundimtare do të jetë suva dekorative apo nëse sipërfaqja do të vishet me pllaka, sipërfaqe mund të tërhiqet dhe jo të lëmohet. Pasi suvaja është fortësuar mjaftueshëm, laget pak dhe lëmohet me bërdafe ose me makineri lëmimi.

